



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 678 prot.,

Datë 05.02.2021

**VENDIM**

**NR. 11, DATË 05.02.2021**

**PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE  
PROCEDURAVE PËR MONITORIMIN E MBULIMIT NGA OFRUESIT E  
SHËRBIMIT MEDIATIK AUDIO/AUDIOVIZIV TË FUSHATËS ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 16 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e udhëzimit “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin e mbulimit nga ofruesit e shërbimit mediatic audio/audioviziv (OSHMA) të fushatës zgjedhore” sipas tekstit, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Gentian SALA**

**Zëvendëskryetar:**

**Sami NEZAJ**

**Anëtarë:**

**Agron GJEKMARKAJ**

**Gledis GJIPALI**

**Suela MUSTA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**UDHËZIM**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR  
MONITORIMIN E MBULIMIT NGA OSHMA-TË TË FUSHATËS ZGJEDHORE**

**Neni 1  
Objekti**

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) gjatë fushatës zgjedhore, përcaktimi i rregullave të regjistrimit, monitorimit të mbulimit nga ofruesit e shërbimit mediatik audio/audioviziv (OSHMA) të fushatës zgjedhore, të hartimit dhe shqyrtimit të raporteve të monitorimit gjatë fushatës zgjedhore.

**Neni 2  
Qëllimi**

1. AMA në zbatim të parashikimeve të Kodit Zgjedhor monitoron pasqyrimin e fushatës zgjedhore në subjektet ofrues të shërbimit mediatik audio/audioviziv (OSHMA).
2. AMA në cilësinë e organit kolegjal, në ushtrim të veprimtarisë së tij gjatë fushatës zgjedhore e ushtron aktivitetin e tij vendimmarrës, në zbatim të Rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 209, datë 16.09.2016, të ndryshuar.
3. Përrjashtimisht për mbledhjet e AMA-s, në periudhën e fushatës zgjedhore dhe për çështje që lidhen me monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore në OSHMA-të, njoftimi për zhvillimin e mbledhjes, shoqëruar me materialet pjesë e rendit të ditës, kryhet brenda ditës.

**Neni 3  
Procedurat e regjistrimit**

1. Studio e regjistrimit pranë AMA-s ka kapacitet regjistruar për 48 programe/kanale. Regjistrimi i programeve/kanaleve gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, do të bëhet në bazë të listës së subjekteve të miratuara nga AMA. Përgjegjës për funksionalitetin dhe regjistrimin në studio, do të jetë përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit në Drejtorinë e Mbikëqyrjes si dhe tekniku i studios së turnit përkatës.



2. Personat përgjegjës do të mbajnë çdo fillim dite një procesverbal, në të cilin do të listohen programet/kanalet që kanë qenë në transmetim ditën paraardhëse si dhe platformën nga e cila janë kryer regjistrimet.
3. Në rast se personat përgjegjës konstatojnë probleme për regjistrimin dhe mirëfunksionimin e studios së monitorimit do të njoftojnë menjëherë Komisionin Ad-Hoc për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore.
4. Procesverbali nënshkruhet nga përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit në Drejtorinë e Mbikëqyrjes dhe tekniku i studios i turnit përkatës. Procesverbali protokollohet dhe arkivohet në zyrën e arkivës dhe protokollit të AMA-s.

#### **Neni 4**

#### **Komisioni Ad Hoc për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore**

1. Pranë AMA-s ngrihet Komisioni Ad Hoc për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore në subjektet ofrues të shërbimit mediatik audio/audioviziv (OSHMA).
2. Komisioni Ad Hoc për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore në ushtrim të funksioneve të tij zbaton:
  - Dispozitat e Kodit Zgjedhor;
  - Dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
  - Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative;
  - Aktet nënligjore të miratuara nga KQZ, për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore.
3. Komisioni Ad Hoc për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore ka qëllim që nëpërmjet veprimtarisë së tij, të sigurojë mirëorganizimin e monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore në OSHMA-të, në përmbushje të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor, ligji organik nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullorja për Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe Vendimi i KQZ-së për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audiovizive.
4. Në Sekretariatin Teknik të ngritur nga AMA, me vendimin nr. 248, datë 21.12.2016, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik dhe përcaktimin e masës së pagesës për Sekretariatin Teknik”, të ndryshuar, në funksion të mirëorganizimit dhe mbarëvajtjes së mbledhjeve së organit kolegjal, (Këshillit të AMA-s) shtohet edhe një nëpunës civil nga Drejtoria Juridike dhe Licencave, i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ky udhëzim për organizimin e mbledhjeve të AMA-s, përgatitjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit lidhur me monitorimin e fushatës zgjedhore, zbardhjen, publikimin dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve të AMA-s për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore në OSHMA-të.
5. Komisioni Ad Hoc për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore në OSHMA-të, shpërblehet në masën e 2 pagave mujore.

#### **Neni 4**

#### **Përbërja e Komisionit Ad Hoc për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore**

Komisioni Ad Hoc për monitorimin e mbulimit të fushatës zgjedhore përbëhet nga:

1. Kryetari i AMA-s, i cili drejton dhe mbikëqyr punën e Komisionit Ad Hoc;



2. Zëvendëskryetari i AMA-s;
3. Kryetari i Këshillit të Ankesave;
4. Këshilltari i Kryetarit;
5. Drejtori i Drejtorisë së Programeve;
6. Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes;
7. Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Licencave.

## **Neni 5**

### **Detyrat e Komisionit Ad Hoc për monitorimin e fushatës zgjedhore**

1. Komisioni Ad Hoc për monitorimin e fushatës zgjedhore është përgjegjës për zbatimin dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ligji organik, Kodi Zgjedhor dhe Vendimi i KQZ-së për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio/audi vizive, që nga procesi i regjistrimit të përmbajtjeve të transmetuara në OSHMA-të e përzgjedhura për t'u monitoruar dhe gjatë procesit të përgatitjes dhe shpërndarjes së dokumentacionit lidhur me raportet e monitorimit, ndjekjen e zbatimit të vendimeve të AMA-s dhe dërgimin e tyre në KQZ.
2. Në veçanti, Komisioni Ad Hoc për monitorimin e fushatës zgjedhore ushtron këto funksione:
  - a. Koordinon procesin e funksionimit optimal të infrastrukturës teknike dhe teknologjike për monitorimin e fushatës zgjedhore, që kryhet nga administrata e AMA-s dhe monitoruesit e kontraktuar për këtë qëllim.
  - b. Ndjek procesin e përpunimit të të dhënave të raportit ditor të monitorimit hartuar prej nëpunësve të ngarkuar.
  - c. Mbledh, analizon dhe administron raportet ditore të monitorimit.
  - d. Përcjell çdo ditë në KQZ raportet ditore të monitorimit.
  - e. I propozon AMA-s, listën e subjekteve OSHMA që do të përfshihen në monitorim në javën vijuese duke e shoqëruar propozimin me arsyetimin përkatës.
  - f. Përgatit raportet javore të monitorimit, mbi bazën e raporteve ditore të monitorimit të cilat duhet të jenë të detajuara dhe të përmbajnë:
    - OSHMA-të që janë monitoruar;
    - Llojin e platformës së transmetimit;
    - Kohën e monitorimit për çdo OSHMA;
    - Minutazhin e transmetimeve zgjedhore të partive politike;
    - Minutazhin apo hapësirën që i jepet çdo aktori politik;
    - Kohën apo hapësirën që u jepet fjalimeve të drejtpërdrejta të çdo aktori politik ose intervistat me ta;
    - Radhën e vendosjes së kandidatëve apo partive në edicionet informative;
    - Raportin gjinor të mbulimit mediatic të kandidatëve.
  - g. I përcjell AMA-s për miratim, raportet e detajuara të monitorimit ku pasqyrohen gjetjet, konkluzionet e monitorimit bazuar në treguesit e mbledhur nëse subjekti i monitoruar ka vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale dhe konstatimet mbi shkeljet e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga ana e OSHMA-ve.
  - h. Përgatit relacionin dhe projektvendimin "Për shqyrtimin e raporteve javore të monitorimit të fushatës zgjedhore".
  - i. Përfaqëson AMA-n në KQZ për prezantimin e raporteve javore të monitorimit.

- j. Në rast të paraqitjes së ankesave prej OSHMA-ve me lëndë rishikimin e rezultateve të të dhënave të monitorimit, shqyrton ankimin dhe nëse ky i fundit është i mbështetur pranon kërkesën duke korigjuar të dhënat e raportit. Në rast se ankimi është i pabazuar, subjekti ankues njoftohet për refuzimin e kërkesës, së bashku me arsyetimin përkatës.
- k. Të dhënat e korigjuara të raporteve të monitorimit përfshihen në raportin javor të monitorimit.
- l. Harton përmbledhjen e raportimeve për pasqyrimin e gjithë fushatës zgjedhore nga OSHMA-të, i cili i përcillet AMA-s për miratim.
- m. Zbaton urdhrat dhe porositë e anëtarëve të AMA.

## Neni 6

### Detyrat e Sekretariatit Teknik gjatë monitorizimit të fushatës zgjedhore

Nëpunësi i Sekretariatit Teknik, ngritur sipas këtij dhe sekretari i AMA-s, gjatë periudhës së monitorimit të fushatës zgjedhore ndihmojnë AMA:

- a. Duke krijuar kushtet e nevojshme për realizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjes;
- b. Duke përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes;
- c. Duke përcjellë njoftime për anëtarët e AMA;
- d. Duke kryer çdo detyrë tjetër në kuadër të asistencës për organizimin e mbledhjes së AMA në lidhje me detyrat që i ngarkohen prej Kodit Zgjedhor;
- e. Njofton anëtarët e AMA, për çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet;
- f. Koordinon punën me Komisionin Ad Hoc për monitorimin e fushatës zgjedhore për materialet, relacionet dhe projektvendimet “Për shqyrtimin e raporteve javore të monitorimit të fushatës zgjedhore”, mban procesverbalin e mbledhjeve të AMA në përputhje me kërkesat e nenit 28 të Rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 209, datë 16.09.2016, të ndryshuar;
- g. Regjistron, publikon dhe arkivon vendimet dhe dosjen me dokumentacionin e shqyrtuar në mbledhjen e AMA, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- h. Zbaton urdhrat dhe porositë e Kryetarit apo anëtarëve të AMA.

## Neni 7

### Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe i shtrin efektet deri në përfundim të monitorimit të fushatës zgjedhore.